



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ministri

8096
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 11.08.2016

UDHËZIM

Nr. 19, datë 11.08.2016

PËR

ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2016, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, 27 dhe 50, të Ligjit Nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Ministrave Nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 352, dt. 03.04.2013 "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit",

UDHËZOJ:

- Zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë, në datat si më poshtë vijon:

a) Gjuhë e huaj	25 gusht 2016
b) Gjuha shqipe	27 gusht 2016
b) Matematika	29 gusht 2016
- Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) të zhvillojnë provimin në lëndën **Gjuhë amtare**, sesioni i dytë, në datën **22 gusht 2016**
- Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në Urdhrin Nr.119, datë 20.03.2016 për miratimin e rregullores për "Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016".
- Provimet kombëtare të arsimit bazë 2016, sesioni i dytë, përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij

udhëzimi, të fillojnë në orën 10:00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.

5. Hartimi i testeve kryhet sipas rregullores për procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2016.
6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën **Gjuhë amtare**, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR Gjirokastrë. Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastrë tezën, ditën e provimit.
7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën **Gjuhë amtare**, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.
8. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR/ZA-ve qendra.
9. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e provimeve kombëtare të Arsimit Bazë 2016, sesioni i dytë.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi: Zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "*Fletore Zyrtare*".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

